



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:285778  
Datë: 28.03.2024  
Numri i dokumentit: 05519187

CAP.nr.343/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Ylber Shurdhiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K.R.K(KRK) në Prishtinë dega në Mitrovicë, kundër debitorëve SH.J.B, E.J, dhe L.K nga Mitrovica, për pagimin e borxhit-kredisë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorës SH.J.B, , të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.380/22, të datës 08.02.2023, me datën 28.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorës SH.J.B, nga Mitrovica, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.380/22, i datës 08.02.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.380/22, i datës 08.02.2023, e ka refuzuar si i pabazuar prapësimin e debitorëve SH.J.B, E.J, dhe L.K nga Mitrovica, të datës 21.12.2022, të paraqitur kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.852/22 të datë 13.12.2022 të Përmbaruesi privat Gj R me seli në Gjakovë.

Kundër këtij aktvendimi, debitorja SH.J.B, në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që të ndryshohet aktvendimi PPP.nr.380/22, i datës 08.02.2023 dhe të aprovohet ankesa si e bazuar.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta refuzoj ankesën e debitorit si të pabazuar dhe ta vërtetoj aktvendimin PPP.nr.380/22, i datës 08.02.2023.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit

për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore dhe gjeti se:

-Ankesa e debitorit, është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 13.12.2022, te Përmbartuesi Privat Gj R, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të Marrëveshjes për Kredinë nr.KOMI-009123-002, e datës 22.04.2020, Konfirmimit të regjistrimit të Pengut me numër R-20220325-26 te datës 25.03.2022. Përmbartuesi Privat ka nxjerr urdhrin me të cilin e ka caktuar përmbartimin e propozuar P.nr.852/22, e datës 13.12.2022.

Gjykata e shkallë së parë ka nxjerrë aktvendimin tani të ankimuar, me të cilin e ka refuzuar prapësimin e debitorëve, duke arsyetuar se pretendimet e debitorëve, janë të pabazuara për faktin se kreditori propozimin për përmbartim e ka parashtruar në bazë të Marrëveshjes së pengut me numër R-20220325-26 të datës 25.03.2022 i cili konsiderohet dokument i besueshëm përmbartues sipas nenit 29 par.1.3 të LPP-së, i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën për të cilën është krijuar ky detyrim. Me nenit 29 par.1.3 të LPP-së, është përcaktuar se: *“Dokumenti i përmbartues është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe shuma e përmbushjes se detyrimit monetar”*. Në rastin konkret dokumenti përmbartues i përmban të gjitha elementet e parapara me dispozitën e cituar andaj përbën dokument të përshatshëm për përmbartim. Ka shtuar se Gjykata, pas shqyrtimit të prapësimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, pretendimet e debitorit në prapësim, ka vlerësuar se janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, sepse nuk ka ofruar asnjë provë në mbështetje të tyre siç është paraparë me nenin 69 par 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit P.nr.852/22 të datës 13.12.2022 të përcaktuara me dispozitat e nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (Ligji nr. 04/L-139) të Republikës së Kosovës.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorëve duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se Marrëveshja për Kredinë nr.KOMI-009123-002, e datës 22.04.2020, Konfirmimi regjistrimit të Pengut me numër R-20220325-26 te datës 25.03.2022, në bazë të cilit organi përmbartues ka caktuar përmbartimin, është titull

përmbartimor dhe si i tillë i plotëson kushtet e parapara me nenin 21, nenin 5.2 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën Përmbartimore dhe nenin 27 para.1 të LPP-së, dhe mbi këtë bazë ky dokument me të drejtë trajtohet si dokument i përshtatshëm për përmbartim. Në rastin konkret sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, pavarësisht se gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar prapësimin e debitorëve mbi një bazë tjetër, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm për faktin se Marrëveshja për Kredinë nr.KOMI-009123-002, e datës 22.04.2020 dhe Konfirmimi regjistrimit të Pengut me numër R-20220325-26 te datës 25.03.2022, në bazë të cilave është lejuar përmbartimi është titull përmbartimor dhe si i tillë i plotëson kushtet e parapara me nenin 21, nenin 5.2 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën Përmbartimore dhe nenin 27 para.1 të LPP-së, dhe mbi këtë bazë ky dokument me të drejtë trajtohet si dokument i përshtatshëm për përmbartim.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorës lidhur me atë se aktvendimi i atakuar është përfshirë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret përmbartimi është lejuar në bazë Marrëveshja për Kredinë nr.KOMI-009123-002, e datës 22.04.2020 dhe Konfirmimi regjistrimit të Pengut me numër R-20220325-26 te datës 25.03.2022, i cili është titull përmbartimor, andaj edhe në këtë drejtim rezultojnë si të pathemelta pretendimet ankimore të debitorës.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbartimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur t'i shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbartimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë, të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se "në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual".

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
CAP.nr.343/23, me datë 28.03.2024

G j y q t a r i,  
Ylber Shurdhiqu